

PRANVERA TELI (DIBRA)**KRIZA E MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO-ITALIANE
NË OPTIKËN DIPLOMATIKE ANGLEZE
(1931-1934)***

Marrëdhëniet shqiptaro-italiane, të konsoliduara me nënshkrimin e dy traktateve të Tiranës në vitet 1926-1927 dhe investimeve të konsiderueshme italiane në Shqipëri, pas një qetësie relative të viteve 1928-1930, njohën një periudhe ftohjeje të pasuar nga një acarim në rritje, një periudhe që do të zgjaste vite dhe në pamje të jashtme do të krijonte përshtypjen se Shqipëria ishte kthyer në një vatër të rrezikshme në Evropë.

Pas konsolidimit të regjimit të tij brenda vendit, Musolini në vitin 1930 deklaroi hapur para Sekretariatit të Federatës Fashiste se Italia përgatitej për një luftë në kufijtë e saj, se për këtë ajo duhej armatosur, sepse nuk mund të shtrihej paqësisht drejt lindjes, se ishte absurde të mendoje se traktatet ishin të shenjta dhe të pacenueshme, se fashizmi po ndërkombëtarizohej dhe se Evropa nuk kishte rrugë tjetër veçse të fashistizohej.¹

Këto rrethana të jashtme, të shoqëruara me një ndjenjë antiitaliane në rritje në të gjitha segmentet e shoqërie shqiptare, e nxitën mbretin Zog të fillonte gradualisht pengimin e ndikimit Italian në Shqipëri dhe njëkohësisht të përpiqej që të gjente hapësira të reja diplomatike në favor të interesave të shtetit shqiptar.

Duke e konsideruar këtë moment si mjaft delikat dhe serioz për mbijetesën e shtetit shqiptar të varur deri tani politikisht dhe ekonomikisht tek Italia fashiste, ashtu siç kishte ndodhur në momente të vështira edhe në vitet 20-te², Mbreti dhe qeveria shqiptare iu drejtua Londrës zyrtare për mbështetje dhe këshillë të paanshme. Britania e Madhe përfaqësonte fuqinë më të madhe diplomatike evropiane për kohën, që nuk kishte interesa direkte në Evropë e veçanërisht në Shqipëri, por përkundrazi e shikonte këtë të fundit si një

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë: “Monarkia Shqiptare, 1928-1939”, organizuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë, 1 shtator 2008.

¹ Ilir Ushtelenca, *Diplomacia e Mbretit ZOGU I-rë*, Tiranë: 1995, f.228-229.

² Pranvera Teli (Dibra), *Shqipëria dhe Diplomacia Angleze, 1919-1927*, Tiranë: 2005.

stabilizator të konflikteve midis fqinjëve të saj tokësor dhe detar. Me pozitën e saj të “arbitrit ndërkombëtar” Anglia luajti rol të madh në formimin e tërë konstelacionit politik të Evropës në vitet '20-'30.³ Parë nga ky aspekt, politika angleze kishte rëndësi të madhe për fatet e Shqipërisë në periudhën midis dy Luftërave Botërore.

Ndërkohë qëllimi i qeverive britanike në periudhën midis dy Luftërave Botërore, të kënaqura nga çfarë kishin arritur nga Lufta e Parë Botërore, ishte ekuilibri i balancuar midis fuqive të mëdha evropiane, ekuilibër që do të garantonte paqen dhe prosperitetin britanik të bazuar në tregtinë ndërkombëtare dhe qetësinë e rrugëve detare⁴. Ky qëllim i shoqëruar me krizën ekonomike botërore të viteve '30, e shtërngoi Anglinë dhe fuqitë e tjera të mëdha që t'i qetësonin konfliktet midis tyre dhe të gjenin zgjidhje për të kapërcyer vështirësitë e tyre. Në vitin 1931, Anglia shpalli politikën e saj thjeshtë pacifiste për të qetësuar e zbutur konfliktet në Evropë. Veçanërisht ajo u përpoq të qetësonte konfliktin midis bllokut francez dhe atij italian dhe të sjellë çarmatimin. E bllokuar nga problemet ekonomike, e duke kundërshtuar hegjemoninë franceze kryesisht në Evropën Lindore, FO përkrahte Italinë, por nga ana tjetër frikësohej nga krijimi i blloqeve, e prandaj përpiquej që të arrihej marrëveshja dhe ekuilibri franko-italian në situata dhe rrethana të ndryshme. Këtu e ka burimin e vet edhe riinteresi i Anglisë për Shqipërinë⁵, të cilën pas vitit 1927 e kishte nxjerrë konsiderueshëm nga axhenda e saj diplomatike duke i lënë dorë të lirë Italisë për të forcuar pozitat e saj në atë vend.⁶

Me dobësinë e saj ekonomike e politike, si dhe me pozicionin e saj të favorshëm strategjik në Adriatik, Shqipëria përbente gjithnjë një pikë konfliktuale midis Romës e Beogradit për dominim në këtë vend. Duke vënë në një anë të balancës këtë fakt dhe nga ana tjetër kushtet e reja të krijuara në marrëdhëniet ndërkombëtare në vitet '30, interesat italiane, aleancën franko-jugosllave dhe qëllimet e politikës së jashtme britanike, Londra diplomatike u përpoq ta përcillte me mjaft kujdes krizën e marrëdhënieve shqiptaro-italiane te fillimit të viteve 30-të.

Viti 1931 ishte viti i rinovimit të Traktatit të Parë të Tiranës, nënshkruar në nëntor 1926, dhe të Traktatit të Sigurisë Franko-Jugosllave të nënshkruar në vitin 1927. Me qëllim që të shmangte rinovimin e pakteve në kuadrin edhe të angazhimeve të tij publike për çarmatimin në Evropë, Musolini i propozon palës jugosllave në janar të vitit 1931 që të fillonin bisedimet dypalëshe ku

³ Vuk Vinaver, “Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë midis dy luftërave botërore”, *Gjurmime Albanologjike I*, Prishtinë, 1968.

⁴ R.J.Q. Adams, *British Politics and Foreign Policy in the Age of Appeasement*, USA 1993, f.7.

⁵ V. Vinaver, *art. i cit.*, f. 221.

⁶ P. Teli (Dibra), *vep. e për.*

pavarësia e Shqipërisë të ishte baza e një antante të gjatë italo-jugosllave. Ky hap u përshëndet nga Londra zyrtare, por u hodh poshtë nga pala jugosllave për sa kohë që propozimi shoqërohej me kushtin që qeveria jugosllave duhej të njihnte Rezolutën e Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1921 e cila i jepte Italisë një pozicion të privilegjuar në Shqipëri, pozicion të cilin Beogradi e shihte si kërcënim për sigurinë e Jugosllavisë. Ministri i Jashtëm jugosllav, Djouritch propozonte që në qoftë se vërtet Italianet kërkonin të arrinin një zgjidhje të qëndrueshme, asnjë nga palët nuk duhet të përmende Rezolutën e vitit 1921 dhe në vend të saj të ngrihej një sistem i ri që në praktike do të çonte në çfuqizimin praktik të kësaj rezolute dhe njëkohësisht tek mosrinovimi i Traktatit të Tiranës. Në këtë pikë Beogradi priste mbështetjen e qeverisë britanike.

Të pushtuar nga politika pacifiste, Foreign Office ndjehet e paqartë se çfarë pritej nga ajo të bënte. Ajo ishte e sigurt se duke demonstruar shumë angazhim në këtë çështje dhe duke ndërhyrë pranë qeverisë italiane për të nxitur bisedimet me jugosllavët, ajo do të bënte dëm më shumë sesa do të kishte rezultat, meqenëse ky veprim do të konsiderohej nga Musolini si ndërhyrje në zonat e tij të interesave. Nga ana tjetër, duke qenë edhe nënshkruese e rezolutës së vitit 1921, Londra nuk ndihej e gatshme për ta sjellë çështjen në Lidhjen e Kombeve, sepse ishte e mbërthyer nga angazhimet e saj si nënshkruese e Rezolutës.⁷ Në këtë ngërç të situatës, ministri anglez në Beograd, Neville Henderson, i propozon qeverisë jugosllave në maj të vitit 1931, që zgjidhja më e mirë për të dy palët do të ishte që dy qeveritë të binin dakord, që në rast të një krize politike shqiptare që kërcënonte pavarësinë e integritetin e saj, të dy qeveritë së bashku të bënin rastin prezent në LK për të marre masat e duhura me qëllim që të vendosej rregull në vend. Beogradi e konsideroi të pranueshme këtë zgjidhje në rast se pranohej nga Roma.⁸

Ministri i Jashtëm Italian Sinjor Grandi, e hodhi poshtë këtë zgjidhje që sipas tij nënkuptonte që Italia duhej të sakrifikoje pozicionin e saj të veçantë në Shqipëri, pozicion që ia kishte dhënë vendimi i fuqive të mëdha dhe që e kishte siguruar konkretisht nëpërmjet investimeve të saj të dhimbshme ekonomike e njerëzore. Grandi shprehej për diplomatet angleze që qeveria italiane ishte e gatshme të hidhte poshtë Paktin e Tiranës në rast të arritjes së një marrëveshjeje të kënaqshme me Jugosllavinë për tërë çështjen. Ai vazhonte që “ Shqipëria është për Italinë një interes në detin Adriatik, që do të thotë një interes jetësor për të, ndërsa për Jugosllavinë është vetëm një interes

⁷ Public Record Office (më tej: PRO), Foreign Office (më tej: FO) 371/15146, C.2641/475/90, Londër 21.04.1931

⁸ PRO, FO 371/15146, C3444/475/90, Beograd, 12 maj 1931.

ballkanik” një vlerësim që në FO u përkthye si një refuzim i paramenduar dhe kokëfortë për të njohur faktet.⁹

Londra e shikonte me shqetësim në rritje tensionin në marrëdhëniet italo-jugosllave me subjekt Shqipërinë . “Ky tension midis tyre helmon tërë atmosferën në Evropën Jug-Lindore, dhe nuk ka perspektivë të një stabiliteti real në këtë zonë për sa kohë që ky tension vazhdon-analizonte ministri anglez në Beograd”. Ai propozonte që kjo situatë duhej të diskutohej në konferencën e çarmatimit që do të mbahej vitin tjetër.¹⁰

Për Ministrin anglez në Shqipëri, Hodgson një shpresë tjetër për zbutjen e këtij tensioni ishte mos-rinovimi i Paktit të Parë të Tiranës. Rinjohja e tij-shprehet ai-do të nxisë dyshimet jugosllave. Për sa kohë që mbreti Zog mbetet në fron, shanset për një lëvizje të brendshme që të rrezikojë përmbysjen e regjimit të tij janë të dobëta, që do të thotë që Italia ka shanse më pak për të ndërhyrë për të ruajtur *status-quo*-në një vend, angazhim që ia njeht Traktati në fjalë, por që do të shkaktonte një kundërreagim të armatosur nga ana e Beogradit. Në qoftë se Mbreti Zog-vazhdon ai në raportin e tij për FO-largohet nga skena, atëherë ekziston një mundësi e sigurt që edhe regjimi të cilit ai i dha emrin e tij të bie bashkë me të. Atëherë nuk ka status quo për tu vendosur nga Italia. Shqipëria do të jete përsëri në një pike shkrirjeje.¹¹

Duke mos parë asnjë dritë jeshile nga ana e Beogradit për të pranuar pozicionin dominant të Italisë në Shqipëri, Roma vazhdoi bisedimet me palën shqiptare për dhënien e një huaje 10-vjeçare, marrëveshja për të cilën u nënshkrua në Tiranë me 24 qershor 1931. E ndodhur në vështirësi të mëdha financiare dhe pas konsumimit të huasë SVEA të nënshkruar në vitin 1925, qeveria shqiptare në kuadrin e qëllimeve të saj për të zvogëluar ndikimin Italian në Shqipëri po studioonte mundësi të ndryshme për të gjetur një rrugëdalje nga kriza financiare që kishte kapur vendin. Përpjekjet rezultuan të pasuksesshme. Vetëm Italia kishte treguar gatishmëri për ta nxjerre Shqipërinë nga vështirësitë e saj financiare duke dhënë një hua të konsiderueshme, por ndryshe nga herët e tjera këtë radhë qeveria italiane do të kontrollonte mënyrën e shpenzimit të saj.¹²Për këtë mori dijeni edhe ministri anglez në Durrës, Hodgson. Ajo çfarë alarmoi më tepër Londrën ishte fakti që edhe pse nuk thuhej publikisht, kjo hua do të shkonte më tepër për shpenzime ushtarake në vend sipas orientimeve që do të jepte misioni ushtarak Italian në Shqipëri.

Kjo e komplikoi më tepër situatën e tensionuar në marrëdhëniet italo-jugosllave mbi Shqipërinë dhe rriti dyshimet e qeverisë jugosllave për projektet

⁹ PRO, FO 371/15146, C3910/475/90, Romë, 1 qershor 1931; PRO, FO 371/15146, C5026/475/90, 4 korrik 1931.

¹⁰ PRO, FO 371/15146, C3951/475/90, Beograd, 3 qershor 1931

¹¹ PRO, FO 371/15146, C3947/475/90, Durrës, 2 qershor 1931.

¹² PRO, FO 371/15148, C.2808/2808/90, Durrës, 20.04.1931.

italiane për ndërhyrje ushtarake në Ballkan nëpërmjet Shqipërisë. Për të parë gjendjen në vend, qeveria britanike dërgoi atasheun ushtarak të legatës së saj në Romë, i cili konfirmoi faktin që ushtria shqiptare ishte e vendosur totalisht nën kontrollin Italian¹³. Ky fakt publik zbehte mundësitë e një mirëkuptimi italo-jugosllav. Duke patur parasysh këtë fakt, e në kushtet kur Jugosllavia ishte aleate e deklaruar e Francës në Ballkan, në FO e shihnin të vështirë arritjen e një mirëkuptimi midis Italisë dhe Jugosllavisë, përse kohë që nuk arrihej mirëkuptimi italo-francez në Evropën Lindore. Situata mund të zbutej pak me mosrinovimin e Traktatit të Sigurisë franko-jugosllave dhe me arritjen e një pakti trepalësh midis Francës, Italisë dhe Jugosllavisë, që do të garantonte stabilitet në rajon, realizimi i të cilit për momentin dukej i pamundur.

Përse kohë që pakti trepalësh nuk ekzistonte, për qeverinë britanike protektorati italian mbi Shqipërinë në rrethanat aktuale konsiderohej si garancia më e mirë për paqe të cilën ajo shpresonte të siguronte. “Deri sa Shqipëria të arrihe një zhvillim politik, ekonomik dhe social të afërt me pjesën tjetër të Evropës, e ka në të vërtetë të vështirë të ruaj një pavarësi reale, dhe pavarësia e saj fiktive është një joshje e vazhdueshme dhe provokacion për shtetet që e rrethojnë. Ishte kjo arsyeja që ne pranuan vendosjen në një farë mënyre të protektoratit Italian në Shqipëri pas nënshkrimit të traktatit të dytë të Tiranës në vitin 1927.”¹⁴

Duke parashikuar një komplikim të situatës së brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë, shkak për të cilën në optikën diplomatike angleze mund të bëhej fillimi i lëvrimit të huasë nga qeveria italiane, rinovimi i Paktit të Tiranës apo shëndeti i lëkundur i mbretit Zog, qeveria britanike nxiton të parashikojë edhe rrugët më të mundshme për të vepruar në këtë situatë të cilësuar “vallëzim i Evropës mbi vullkanin e Adriatikut”. “Në emër të paqes evropiane ne duhet të rishikojmë politikën tonë për të përcaktuar drejtimin që duhet të marrim në një situatë të tillë”. U analizuam disa mundësi veprimi. Mundësia e parë ishte që të vazhdohej të jepeshin rekomandime tek tre palët në konflikt, por pa kaluar në diskutime bilaterale. Mundësia e dytë, Shqipëria të deklarohet si çështje që i përkiste Italisë, për sa kohë që kjo e fundit kishte një mandat jozyrtar mbi Shqipërinë të sanksionuar nga Konferenca e Ambasadorëve e vitit 1921. Ky reagim i qeverise britanike do ta hidhte akoma më shumë Jugosllavinë në krahët e Francës, dhe kjo nuk i shkonte për shtat politikës së jashtme britanike. Mundësia e tretë, t’i behej e qartë qeverisë italiane se Rezoluta e vitit 1921 nuk mund të imponohej mbi një palë të tretë siç ishte Jugosllavia, dhe se për ta bërë këtë ishte i nevojshëm konsensusi i të gjitha palëve nënshkruese të saj. Mundësia e katërt ishte dorëzimi i kësaj çështje pranë Lidhjes së Kombeve për kompetence shqyrtimi. Dy mundësitë e fundit do të priteshin mjaft ashpër në

¹³ PRO, FO 371/15147, C478/478/90, 13 nëntor 1931.

¹⁴ PRO, FO 371/15146, C5007/475/90, FO 10 korrik 1931

Romë e kjo nuk i përshtatej situatës aktuale të ndërthurjes së interesave italo-britanike.¹⁵ Pasi u analizuan të gjitha mundësitë u vendos që për momentin në të cilën ndodhej Evropa dhe në kuadrin e politikës pacifiste britanike, mënyra më e përshtatshme për reagim ishte që të vazhdohej të jepeshin këshilla të mira kur të ofrohej rasti në Romë, Beograd e Tiranë, por pa kaluar në diskutime bilaterale. “Kjo politikë bazohet-thuhet në një memorandum të FO- në faktin që nuk mund të arrihet asgjë e efektshme për sa kohë që nuk ka një zgjidhje franko-italiane, dhe është më mirë për ne që të mos humbasim energjitë tona dhe influencën tonë në rrethanat aktuale të pafavorshme. Ndërkohë të vazhdohen përpjekjet për paktin trepalësh Francë-Itali-Jugosllavi.”¹⁶

Mbi bazën e këtij qëndrimi diplomatik vazhdoi këmbëngulja e Londrës zyrtare pranë qeverisë italiane për rifillimin e bisedimeve me jugosllavët duke propozuar ndonjë formulë tjetër e jo atë të vitit 1921 si bazë për bisedime. Reagimi italian ishte i ashpër. Në vazhdën e reagimeve negative të Romës zyrtare, në FO po bëhej gjithnjë e më e qartë që forca e ndikimit britanik mbi qeverinë italiane ishte zbehur. “Ne, -thuhet në një analizë të FO, - duhet të përballojmë faktin që gjatë dy viteve të fundit ne kemi humbur pushtet për te ushtruar presion jashtë Britanisë dhe është e pamundur që të jemi të suksesshëm për të ushtruar të vetëm presion mbi Italinë për një politikë më pak të vjetër dhe provokative në Shqipëri. Nga ana tjetër nuk kemi askënd që të na mbështesë në këtë ndërmarrje. Po të kërkojmë ndihmën e Francës, situata komplikohet më tepër. Ne nuk duhet të ndërmarrim asnjë hap që mund të keqinterpretohet në Romë, si një veprim që e kemi nxitur ne. Kjo do të rrëzonte marrëdhëniet anglo-italiane dhe ne kemi interesa të konsiderueshme nga çdo pikëpamje të ruajmë marrëdhëniet të mira me Italinë. Marrëveshja detare dhe çarmatimi janë dy prej tyre. Nuk mendojmë që interesat tona në çështjen shqiptare janë aq të mëdha sa të rrezikojmë një ndarje midis nesh dhe Italisë për këtë pikë, megjithëse si politika italiane në Shqipëri ashtu edhe metodat e ekzekutimit të saj atje janë krejt të kritikueshme dhe i përkasin në fakt një shekulli tjetër.”¹⁷

Traktati i Tiranës, afati të cilit mbaronte në nëntor të vitit 1931, shpejt u kthye në një shkak konflikti midis qeverisë shqiptare dhe asaj italiane, dhe eventualisht ndaloi vërshimin e parasë italiane në Shqipëri. Ndryshe nga sa ishin deklaruar, italianët ushtruan presion mbi Mbretin Zog për rinovimin e Traktatit përballë një situatë të pasigurt në qëndrimin e Jugosllavëve ndaj Shqipërisë¹⁸. Zogu duke u ndjerë mirë në pozitat e tij politike në vend vendosi në fillim të vitit që ishte në të mirë të interesave të vendit të tij dhe të ardhmes

¹⁵ PRO, FO371/15146, C5007/475/90, FO 10 korrik 1931

¹⁶ PRO, FO 371/15146, C 5007/475/90. FO 10 korrik 1931.

¹⁷ PRO, FO 371/15148, C5972/2808/90, FO 14 gusht 1931.

¹⁸ PRO, FO 371/15887, Durrës, 29 dhjetor 1931.

së tij politike, t'i ndalonte italianët të rinovonin Traktatin e tyre, nëpërmjet të cilit ata merrnin përsipër të ruanin status quonë politike, juridike dhe ekonomike në Shqipëri.¹⁹

Mosnjohja e traktatit të Tiranës nuk u prit me ndonjë etuziazëm të madh në Londër. "Rrëzimi i këtij Traktati nuk ndryshon shumë tek pozitat e Italisë në Shqipëri-thuhej në një memorandum të përgatitur nga Central Department në FO. Pozita e Italisë në Shqipëri tashme është mjaft e garantuar nga Traktati Italo-Shqiptar i Aleancës Mbrojtëse, 1927, dhe nga marrëveshja e fundit për huanë 10-vjeçare. Kështu kjo nuk përbën ndonjë avancim të madh në drejtim të zgjidhjes së problemit shqiptar i cili përbën hyrjen për mirëkuptimin italo-jugosllav."²⁰

Megjithatë, mosrinovimi i Traktatit të Tiranës, rriti reputacionin e Mbretit Zog brenda dhe jashtë vendit. Ne FO vlerësonin " Sidoqoftë Mbreti nuk është pro-italian. Ai përpiqet të marrë benifite maksimale nga lidhjet me Italinë, por pa rënë nën influencën italiane..."²¹ Kështu u përcoll në Londër nëntori 1931.

Kjo situatë acaroi marrëdhëniet shqiptaro-italiane. Reagimi i Romës erdhi menjëherë. Ai ishte me karakter ekonomik dhe veprimi i pare ishte bllokimi i kredisë së dhënë konform marrëveshjes së përfunduar vetëm pak muaj më parë. Kjo u pasua nga pretendimet e përfaqësuesve të SVEA-as për shlyerjen e borxhit. Zogu , i ndërgjegjshëm për pozicionin e tij si një përfitues i atyre favoreve të cilat Italia i bënte në përputhje me interesat e saj në Shqipëri, qëndroi fort për ti transmetuar mesazhin qeverise italiane se ai ishte krejt i përgatitur të bënte edhe pa ndihmën italiane në qoftë se ajo nuk jepej mbi bazën e parimeve që karakterizojnë marrëdhëniet miqësore midis dy vendeve. U shkëmbyen nota diplomatike me një gjuhë të ashpër, por të maskuar diplomatikisht.

Fillimi i vitit 1932 e gjeti Mbretin Zog mjaft të shqetësuar për koston e mundshme ekonomike që do të kishte këmbëngulja e tij për mosrinovim e Traktatit. Ministri i Financave u urdhërua të përgatiste dy projekt-buxhete, njëri i ndërtuar mbi faktin që paratë e huasë të parashikuar në marrëveshjen e vitit 1931 do të jepeshin , dhe tjetri mbi faktin që Shqipëria do të jetonte me burimet e veta pa ndihma nga jashtë. Diferenca midis dy projekteve do të nxirrej nga shkurtimet e shpenzimeve në fushën ushtarake. Mbreti mendonte se kjo masë e fundit do të vepronte si një stimulante e fuqishme për të nxitur asistencën italiane në Shqipëri.²²

¹⁹ Bernd Jurgen Fischer, *King Zog and the struggle for stability in Albania*, New York: 1984, f.199.

²⁰ PRO, FO 371/15147, C9185/475/90, FO 9 dhjetor 1931.

²¹ PRO, FO 371/15148, C.2407/1418/90/

²² PRO, FO 371/18338, R3775/67.90, FO 6 korrik 1934.

Para rezistencës pasive të Mbretit Zog, e cila mund të rrezikonte qëllimin e investimeve të deritanishme në Shqipëri, dhe të ndjeshëm ndaj çdo ndërhyrjeje në fushën ushtarake ku ata kishin investuar shumë, qeveria italiane u mundua ta anashkalonte incidentin, të riniste dialogun diplomatik me qeverinë shqiptare dhe të lëvronte këste të vogla të ndihmës ekonomike italiane të shoqëruara me të drejtën e një kontrolli të rreptë të shpenzimit të tyre²³.

Ne vitin 1932, kriza e marrëdhënieve italo-shqiptare njohu dy momente te tjera delikate. Meqenëse huaja SVEA e mbështeste shlyerjen e saj tek të ardhurat doganore, në dhjetor 1932 Roma i propozoi qeverisë shqiptare realizimin e një Bashkimi Doganor që do të ndihmonte në zgjidhjen e problemeve ekonomike shqiptare. Pasi studioi propozimin me anë të ekspertëve të tij, Zogu e refuzoi kategorikisht atë, meqenëse për Shqipërinë e dobët ekonomikisht ky bashkim përkthehej në një humbje të pavarësisë së saj politike.²⁴ Bashkimi doganor do të shënonte hapin vendimtar drejt aneksimit përfundimtar të Shqipërisë dhe shtrirjen e parë të Italisë në Ballkan.²⁵ Ky aksion i Italisë në FO u konsiderua si një dëshirë e Romës për të bërë të pavlefshme aleancën e përtërirë franko-jugosllave të vitit 1927.²⁶ Duke e ndjerë këtë synim, qeveria franceze protestoi diplomatikisht kundër këtij propozimi dhe kërkoi ndërhyrjen e qeverisë britanike në Romë për sqarimin e situatës.²⁷ Në opinionin evropian u krijua një alarm i vërtetë nga seria e protestave jugosllave në Londër dhe Paris. Në këto kushte diplomacia britanike u detyrua të prononcohet publikisht. Ambasadori anglez në Romë, Graham, deklaroi se Italia dhe Shqipëria nuk janë vende fqinje, prandaj një bashkim i tillë doganor do të thotë vetëm acarim i konfliktit jugosllavo-italian mbi Shqipërinë.²⁸

Megjithatë refuzimi shqiptar ishte një goditje tjetër për Romën dhe politikën e saj në Shqipëri. Situata e nderë u komplikua më tej nga reforma që ndërmori qeveria shqiptare për ngritjen e një sistemi vërtet kombëtar të arsimit në Shqipëri, larg influencave të huaja politike e kulturore.²⁹ Qeveria shqiptare shtetëzoi të gjitha shkollat private duke përfshirë edhe ato ku jepej vetëm gjuha shqipe për të aplikuar kudo një program unik arsimor kombëtar. Reforma preku kryesisht shkollat italiane, sidomos ato të hapura në zonat katolike në veri të vendit, të cilat financoheshin nga qeveria italiane, por nuk lejohej kontrolli i

²³ A.Cici, *Marrëdhëniet Shqiptaro-Italiane në vitet 1920-1934*, Tiranë: 2002, f.200.

²⁴ B. Fischer, *The rise...*, f.210.

²⁵ A.Cici, *vep. e për.*, f.203.

²⁶ PRO, FO 371/16623, C 118/4/90, 4 janar 1933.

²⁷ PRO, FO 371/15887, C 10978/122/90, 30 dhjetor 1932.

²⁸ V. Vinaver, *art. i cit.*, f.224.

²⁹ B. Fischer, *King Zog and struggle...*, f.211.

qeverise shqiptare mbi to.³⁰ Kjo ishte një goditje tjetër ndaj orekseve çkombëtarizuese të Italisë dhe pretendimeve të vendeve fqinje si dhe një riafirmim i pavarësisë të vendit para fqinjëve, sidomos Italisë.³¹

Diplomacia angleze po ndiqte me kujdes zhvillimet në marrëdhëniet italo-shqiptare. Të trembur nga regjimi i mundshëm negativ i Beogradit në këtë situatë të acarimit të marrëdhënieve shqiptaro-italiane, ata këshilluan qeverinë jugosllave që qëndrimi më i zgjuar nga ana e saj në këto rrethana, ishte një indiferencë e plote ndaj konfliktit italo-shqiptar e shoqëruar nga një vendosmëri për të mos kërkuar pretekst për të përfutur nga kjo situatë.³²

I gjendur ngushtë para presionit italian, mbreti Zog filloi përpjekjet për të gjetur hapësira të tjera në politikën e jashtme si në kuadrin dypalësh ashtu edhe në atë shumëpalësh për ta mbështetur atë politikisht dhe ekonomikisht në këtë situatë. Në FO lind shqetësimi se nëse Zogu do ti drejtohej Lidhjes së Kombeve, siç do të bënte çdo anëtar i saj i ndodhur në një situatë të tillë, kjo do ti zemëronte shume italianët, dhe në qoftë se jugosllavët do ta merrnin këtë iniciativë, siç kishte propozuar qeveria jugosllave, mundësitë për një përmirësim real të marrëdhënies italo-jugosllave do të komprometoheshin seriozisht. “Për këtë arsye, shprehen në FO, ne nuk duhet ti inkurajojmë këto iniciativa. Nëse rezoluta e vitit 1921 na ka shkaktuar trazira, një thyeje serioze midis Shqipërisë dhe Italisë do të na shkaktonte një shqetësim akoma më të madh. Sigurisht në këtë moment ne nuk dëshirojmë të gjejmë veten tonë në konflikt me Italinë si rezultat i ndonjë shprehje simpatie ndaj Shqipërisë. Edhe pse ky vend është çorientuar nga politika italiane për arsye politike ne duhet ta refuzojmë propozimin”³³.

Londra nuk e inkurajoi palën shqiptare që ti drejtohej Lidhjes së Kombeve për përfitim të një huaje me pretekstin se financiarisht kjo ishte e pamundur në kushtet e një ekonomie të lodhur shqiptare që nuk ofronte garanci shlyerje. Nga njëra anë Londra deklaronte se do të përkrahte çdo hua të dhënë nga kushdo në qoftë se kjo nuk kundërshtohet nga qeveria italiane. Ndërsa, nga ana tjetër, ambasadori anglez në Beograd instruktohej që jugosllavët duhej të kthenin mbrapsht çdo propozim të Mbretit Zog për të prezantuar çështjen në Lidhjen e Kombeve, pasi çdo interesim i treguar nga pala jugosllave do të keqinterpretohet në Romë dhe në të njëjtën kohë do të ngjallte shpresa të kota në Shqipëri të cilat do të pasoheshin nga zhgënjimi. Njëkohësisht jugosllavët duhet të kthenin mbrapsht kërkesën e Zogut për ndihme ekonomike, sepse çdo

³⁰ I. Ushtelenca, *vep. e përm.*, f.243; PRO, FO 371.18338, R3775/67/90, FO 6 korrik1934

³¹ *Po aty*, f.245.

³² PRO, FO 371/16624, C5172/2873/90, Durrës, 29 maj 1933.

³³ PRO, FO 371/16625, C5502/5502/90, FO 20 qershor 1933.

konkurrencë që u behej italianëve në këtë aspekt prishte frymën e ekuilibrit për të cilën po përpiqeshin prej kohësh.³⁴

Për ambasadorin anglez në Shqipëri, Hodgson, ajo çfarë kërkohet për të mundësuar ngushtimin e spektrit të konfliktit midis Italisë dhe Jugosllavisë mbi Shqipërinë, ishte neutralizimi i Shqipërisë. “Kjo mund të arrihet- shkruan ai për FO-, kur të tre fqinjët e saj Jugosllavia, Greqia e Italia do të firmosnin një vetëmohim të sundimit, siç bënë Italia dhe Austria në vitin 1900. Në këtë instrument të tre palët duhet të angazhohen që në çdo rrethanë të vetëpërbahen nga dhunimi i pavarësisë së Shqipërisë ose integritetin e kufijve të saj nëpërmjet veprimeve ushtarake nga brenda vendit ose të drejtuara kundër tij nga jashtë. Përfundimi marrëveshjes së këtij lloji do të a) siguronte pavarësinë e Shqipërisë b) lejonte atë të zhvillonte burimet e saj pa pasur nevojë të shpenzojë të ardhurat e saj për armatime., dhe c) zhvendoste nga fusha e marrëdhënieve ndërkombëtare një shkak potencial për çrregullime serioze.”³⁵

Londra nuk e gjeti të mundur realizimin e sugjerimit të Hodgson, sipas të cilit problemi shqiptar mund të zgjidhet nga një marrëveshje midis Italisë, Jugosllavisë e Greqisë për neutralizimin e vendit. “...Është një ide që mund të japë fryte në qoftë se ndonjëherë italianët dhe jugosllavët do të vendosnin vërtet që të arrinin një marrëveshje të përgjithshme për zhvendosjen e të gjitha çështjeve të rëndësishme nga debati midis tyre, por njëkohësisht është e qarte që nuk është një ide për të cilën ne mund të marrim iniciativën për ta propozuar. Gjithçka varet nga një përpjekje e sinqertë italo-jugosllave për rivlerësimin e gjërave.”³⁶

Në optikën diplomatike angleze, në interes të ruajtjes së paqes duhej që Italia të përpiqej që praninë e saj në Shqipëri të mos e shoqëronte me tipare provokative, të cilat nga fqinjët e Shqipërisë perceptoheshin si një rrezik për sigurinë e tyre. Aktiviteti ushtarak i Italisë në Shqipëri, jo penetrimi ekonomik, frymëzoi shqetësim në Beograd-deklarimin diplomatik anglez. “Synimi është i thjeshtë. Duhet nxitur Musolini që manifestimin e simpatisë së tij për Shqipërinë ta veshë me mantelin e pacifizmit. Ndërsa jugosllavët duhet të japin je deklarate pa kushte që në asnjë rrethanë nuk do të dhunojnë integritetin territorial të Shqipërisë. Vetëm në këtë mënyrë sigurohet neutraliteti i Shqipërisë.”³⁷

Marrëdhëniet ndërkombëtare në Evropë po merrnin një formë të re e cila nuk linte asnjë hapësirë të favorshme për lëvizje politike në interes të Shqipërisë së vogël. Fuqitë e Mëdha evropiane kishin filluar të kërkonin

³⁴ PRO, FO 371/16625, C6183/5502/90, Beograd, 1 korrik 1933.

³⁵ PRO, FO 371/18338, R 639/67/90, Durrës, 31 janar 1934.

³⁶ PRO, FO 371/18338, R 639/67/90, FO 23 janar 1934.

³⁷ PRO, FO 371.16624, Durrës, 27 qershor 1933.

krijimin e ekuilibrave dhe garancive të reja midis tyre të ndryshme nga ato të pas Luftës së Parë Botërore. Në mars të vitit 1933 kishin filluar bisedimet mbi paktin katërpalësh Angli-Francë-Itali-Gjermani. Çdo veprim i hapur i qeverisë angleze në favor të kërkesave të Shqipërisë do të acaronte marrëdhëniet e saj me Italinë.³⁸

Në këto kushte, qeveria angleze përpiket të ndikojë diplomatikisht në parandalimin e një ndarjeje italo-shqiptare që nuk u shkonte për shtat interesave të saj politike në rajon. Nga njëra anë, qeverisë shqiptare iu propozua nga përfaqësuesi anglez në Durrës që të fillonte të shlyente sadopak nga këstet e borxhit SVEA-s, si një shenjë ogurmirë në Romë për përgjegjësinë që ndjente pala shqiptare në shlyerjen e detyrimeve të saj brenda mundësive të krijuara.³⁹ Nga ana tjetër, qeveria britanike gjatë kësaj periudhe e intensifikoi praninë e flotës angleze në detin Adriatik. Në korrik të vitit 1933 ministri anglez në Durrës Hodgson u njoftua për një vizite të pritshme të flotës angleze të Mesdheut në Adriatik në brigjet shqiptare. Hodgson shprehu rezervat e tij për këtë vizitë në këtë klimë të acaruar të marrëdhënieve shqiptaro-italiane, pas përplasjeve serioze të vitit 1932. Hodgson mendonte se ardhja e anijeve britanike do të interpretohej nga qeveria shqiptare si demonstrim i simpatisë së qeverisë britanike për t'i inkurajuar ato në turbullirat që kishin me Italinë, ndërsa për qeverinë italiane mund të merrte rëndësi politike dhe të rriste xhelozinë për praninë britanike në Adriatik. Ky parashikim u duk i ekzagjeruar në FO. Përkundrazi u mendua që moskryerja e kësaj vizite, që ishte kryer edhe herë të tjera, do të komentohej nga të dy palët si e diktuar nga presioni italian. Nga ana tjetër kjo vizitë, ashtu sikurse në vitin 1926, do të transmetonte në Romë mesazhin se qeveria britanike respektonte interesat e shteteve të tjera në zona të caktuara, siç ishte Adriatiku për Italinë, por asnjë interes nuk përbënte të drejta ekskluzive të një shteti në një zonë të caktuar. Megjithatë, nisur nga rrethanat konkrete, u vendos që ndryshe nga herët e tjera, kësaj radhe vizita e flotës britanike do të përqendrohej vetëm në dy porte detare të Shqipërisë, në Vlorë dhe në Durrës.⁴⁰ Vizita e paralajmëruar e flotës britanike gjeti një pritje dinjitoze nga ana e qeverisë shqiptare dhe u konsiderua si një shenjë e miqësisë shqiptaro-britanike.

Në qershor 1934 marrëdhëniet e acaruar shqiptaro-italiane njohën një pikë kulmore. Në fillim të qershorit 1934, Ministri i jashtëm shqiptar deklaroi se Shqipëria nuk e njihte Rezolutën e Konferencës së Ambasadoreve, 9 nëntor 1921, rezolutë tek e cila qeveria italiane referohej në çdo situatë. Përfaqësuesit e Francës dhe Jugosllavisë në Tiranë e përkrahën menjëherë këtë deklaratë të qeverisë shqiptare. Kjo deklaratë bëhej në një moment kur prestigji i Italisë në

³⁸ A.Cici, *vep. e për.*, f.215.

³⁹ PRO, FO 371/16624, C6458/2873/90, Durrës, 12 korrik 1933.

⁴⁰ PRO, FO 371/16625, C4726/4276/90, Durrës, 15 maj 1933

Ballkan në sytë e opinionit ndërkombëtar ishte cenuar rëndë nga krijimi i Paktit Ballkanik.⁴¹ Me 23 qershor një skuadrinë e flotës ushtarake italiane u ankorua në portin e Durrësit pa njoftuar më parë qeverinë shqiptare. Qeveria shqiptare u alarmua për këtë vizite të papritur të një flote ushtarake. Ministri Italian në Tiranë u shpreh se nuk kishte dijeni për këtë vizitë, por shtoi se midis dy vendeve mike këto lloj njoftimesh nuk kishin shumë rëndësi. Megjithatë qeveria shqiptare kërkoi zyrtarisht shpjegime. Roma zyrtare e justifikoi këtë me faktin se njoftimi për ministrin Italian në Tiranë nuk kishte mbërritur në kohë.

Përfaqësuesit anglez, francez dhe jugosllav në Shqipëri kërkuan moderacion nga ana e qeverisë shqiptare në këtë situatë kritike. Përfaqësuesi anglez kërkoi shpjegime edhe tek ministri italian në Tiranë Koku. Në këto kushte, qeveria shqiptare edhe pse mbajti marrëdhënie kortezie me vizitorët, mori masa për ti rezistuar një zbarkimi të mundshëm Italian, duke dërguar përforcime të xhandarmërisë dhe pajisje ushtarake në zonat përreth. Këto masa u kundërshtuan nga përfaqësuesi anglez dhe u konsideruan të tepërta e të pavlefshme përpara një Italie mjaft të fuqishme ushtarakisht.⁴² Ngjarja u përcoll nga gazetatat kryesore evropiane dhe shkaktoi alarm në kancelari të ndryshme, duke u komentuar si një gjest agresiv nga ana e qeverisë italiane. Në këto kushte, një pjesë e flotës ushtarake italiane u largua me 25 qershor, pjesa tjetër me 30 qershor. Duke konfirmuar presionin psikologjik që synonte të ushtronte tek qeveria shqiptare prania e flotës ushtarake italiane, përfaqësuesi italian Koku i deklaroi ministrin të Jashtëm Vila në takimin që u organizua me rastin e largimit të anijeve se “ Flota iku, por mund të kthehet prapë dhe të qëndrojë gjatë. Ka ardhur koha që qeveria shqiptare t’i japë një zgjidhje çështjeve të varura”. Ministri Vila u përgjigj se zgjidhja mund të jepet vetëm në një atmosferë miqësore dhe të qetë midis dy vendeve, dhe jo nën presionin e flotës ushtarake.⁴³

Kjo ishte shfaqja më e rëndë e acarimit të marrëdhënieve midis dy vendeve. Duke përfituar nga efektet që pati ky incident brenda dhe jashtë Shqipërisë, qeveria shqiptare rifilloi përpjekjet për të gjetur rrugë për të dalë nga tutela ekonomike italiane që impononte edhe tutelën politike. Në të gjitha takimet që Ministri i Punëve të Jashtme, Xhafer Vila, zhvilloi me trupin e huaj diplomatik gjatë ditëve të vështira të qershorit 1934, u kërkua mbështetja ekonomike e këtyre shteteve dhe lidhja e marrëveshjeve tregtare. Shumica e qeverive përkatëse, që nuk u interesonte prania italiane në Shqipëri, morën

⁴¹ I. Ushtelenca, *vep. e përm.*, f.256.

⁴² *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), viti 1934, dos. 49, fl.16.

⁴³ *Po aty*, viti 1934, dos. 49, fl.17, 28.06.1934.

angazhime konkrete për të ndihmuar ekonominë shqiptare në forma të ndryshme.⁴⁴

Për FO, ky veprim nga ana e qeverisë italiane ishte një spekulim dhe vihej re lehtë që koïncidonte me deklaratën e ministrit të jashtëm francez Barthou në vizitën që po zhvillonte në Bukuresht dhe Beograd për solidaritetin që ekzistonte midis Francës dhe Antantës së Vogël. Nga ana tjetër, vizita e paparalajmëruar e flotës ushtarake italiane interpretohej edhe si gjest i shprehjes së autoritetit të Italisë fashiste drejtuar së pari për qeverinë shqiptare dhe së dyti për qeveritë e vendeve të tjera që mund të vinin në diskutim dominimin italian në këtë vend. Megjithatë FO e quan këtë veprim si një përpjekje e pasuksesshme e qeverisë italiane. “I vetmi rezultat i saj-thuhet në një koment të FO- ishte se bashkoi më tepër shqiptarët rreth sovranit të tyre Mbretit Zog.⁴⁵ Megjithatë pas largimit të flotës italiane, pavarësisht nga rezervat që vazhdonte të kishte ministri Hodgson, brigjet shqiptare u vizituan nga flota ushtarake britanike. Ajo u prit mjaft mirë nga opinioni dhe qeveria shqiptare. Komandanti i trupojës ushtarake u prit nga mbreti Zog me mjaft kujdes e dëshirë.⁴⁶

Viti 1934 ishte një vit me probleme për qeverinë italiane. E angazhuar në Evropën Qendrore, në Austri, duke u përgatitur për sulmin në Etiopi vitin e ardhshëm, e duke ndjerë përpjekjet e qeverisë jugosllave për të përfutur nga përkeqësimi i marrëdhënieve të saj me Tiranën zyrtare, qeveria italiane kërkon të zbutë pak tehun e konfliktit me palën shqiptare. Me kërkesën e palës italiane, u organizua në Romë një takim jo formal dhe jo publik midis personave të autorizuar nga dy qeveritë. Në takim u diskutuan problemet e mbetura pezull midis dy qeverive, u vendosën kushte dhe u morën angazhime nga dy palët për zgjidhjen e situatës. Kushtet për palën shqiptare ishin të rënda, ndërmjet të cilave “Shqipëria nuk duhet të kishte politike të jashtme të saj, por në të gjitha çështjet të ndiqte të njëjtën linjë qëndrimi me Italinë, të largoheshin instruktorët e huaj, kryesisht ato anglezë, dhe të qëndronin vetëm instruktorët italiane etj.” Pas përfundimit të takimit, Mbreti Zog vuri në dijeni ministrin anglez Hodgson. Mbreti Zog i paraqiti përfaqësuesit anglez tre alternativa që ai mendonte se mund të përdroreshin për zgjidhjen e situatës. 1-Pranimi i ofertës italiane, një alternative e rrezikshme sepse askush nuk mund të parashikonte se çfarë hapash të tjerë do të ndërmernte Italia drejt forcimit të dominimit të saj në Shqipëri. 2-Pjesëmarrja e Shqipërisë në Aleancën Ballkanike, alternative që kishte mbështetje të madhe nga ana e Jugosllavisë, por që nuk garantonte një asistencë të vazhdueshme ekonomike për vendin, 3-Neutraliteti i Shqipërisë, që për Mbretin ishte alternativa më e mirë në qoftë se do të kishte mbështetjen e

⁴⁴ *Po aty*, fl.11-12.

⁴⁵ PRO, FO371/18338, R3775/67/90, FO 6 korrik 1934.

⁴⁶ PRO, FO371/18839, R R4882/1001/90, FO 25 korrik 1934.

Anglisë dhe Francës. Mbreti Zog kërkoi mendimin e qeverisë britanike se cila mund të ishte alternativa më e mirë për Shqipërinë në situatën aktuale.

Hodgson duke marrë përsipër të shprehë mendimin e tij personal dhe jo atë të qeverisë britanike, dha një përgjigje mjaft të kontrolluar diplomatikisht “ Nuk shoh asnjë bazë mbi të cilën ne mund të ndërhyjmë në një çështje të brendshme të marrëdhënieve midis dy shteteve sovraane, ndërkohe më duhet t’u kujtoj që Britania e Madhe ka firmosur rezolutën e vitit 1921 të Konferencës së Ambasadorëve e cila parashikon të drejtën e Italisë për të pretenduar një pozicion të privilegjuar në marrëdhëniet me Shqipërinë. Dëshira e qeverisë britanike ishte që çdo marrëveshje që Shqipëria mund të arrijë me fqinjët e saj të jetë e tillë që të mos nxisë antagonizmin, por të tentojë të shmangë shkaqet aktuale për konflikt. Shqipëria duhet të përpiqej të jetonte në paqe e miqësi me të gjithë fqinjët e saj. Pozicioni i juaj është mjaft i vështirë, por besoj që ju do të gjeni mënyra për të arritur në një marrëveshje që të pengojë përdorimin e Shqipërisë si një armë të cilën mund ta përdorë një prej palëve në konflikt për të shkatërruar palën tjetër.”⁴⁷ Zogu u shpreh se kjo përfshinte çdo gjë çfarë ai kërkonte të dinte.

FO e miratoi plotësisht qëndrimin e mbajtur nga përfaqësuesi i tyre në Durrës. Për alternativën e dytë dhe të tretë, FO mendonte se mbështetja e Anglisë përballë një Italie të nevrikosur e të çmendur do të ishte e pamjaftueshme dhe jo praktike. Ata ishin në favor të alternativës së parë “ Zogu do të tregohej i zgjuar po të gjente gjuhën me Italinë dhe të hiqte dorë nga lufta e pafrytshme dhe e pabarabartë me të”.⁴⁸ Këtë mesazh e transmetoi Hodgson në një takim të gjatë që pati me Ministrin e Punëve të Jashtme Xhafer Vila. porosia për palën shqiptare ishte “Përpiquni të keni relata të mira me Italinë, por pa u bërë vegla për të shkaktuar armiqësinë e fqinjëve. Miqësi me Italinë, por jo armiqësi me Jugosllavinë. Në çështjet ekonomike përpiquni të keni relata më të gjëra, kurrkush nuk ka të drejtë të ju kundërshtojë. Me ndihmën italiane përpiquni të zhvilloni këto pasurira natyrore kaq të bukura që keni...Në themel, kërkesat italiane janë pa rëndësi. Do të kishte qenë një politikë e urtë sikur në vend të bashkëpunimit ushtarak të kishit bërë një bashkëpunim ekonomik etj”.⁴⁹ Këto deklarata bënë efektin e tyre dhe transmetuan mesazhin që synonin tek Mbreti dhe qeveria shqiptare.

Në përfundim të një takimi kortezie që Hodgson bëri me mbretin Zog, 2 shtator 1934, para se të largohej për një periudhë kohe në Londër Hodgson do ti raportonte FO “ Nga biseda me Zogun krijova përshtypjen që ndonëse ishte krejt i ndërgjegjshëm që duke arritur në një marrëveshje me Italinë, ai do të

⁴⁷ PRO, FO371/18839, R4791/67/90, 24 gusht 1934.

⁴⁸ PRO, FO 371/18839, R4791/67/90, FO 29 gusht 1934.

⁴⁹ AMPJ, v.1934, d.49, fl.28.

përgatiste një fatkeqësi për vendin e tij, ai pak a shumë e kishte ndarë mendjen që të ndiqte linjën e një rezistence me të vogël dhe të fillonte bisedimet”.⁵⁰

Nga ana tjetër, Londra mendonte që një prej arsyeve që e shtynë Italinë që të mos vazhdonte të tregonte forcën në Shqipëri përballë politikës së rezistencës pasive të Zogut, por të rivendoste pozicionin e saj atje, ishin marrëdhëniet e saj me Jugosllavinë. “Roma e ndjen-komentonte FO- se Jugosllavia është më e gatshme për të bashkëpunuar kur ajo e ndjen fort kërcënimin italian në kufijtë e saj me Shqipërinë . Në situatën aktuale Italia ka filluar të frikësohet nga Jugosllavia dhe prezenca e mundshme e saj në Shqipëri. Një frikë reciproke dhe e barabartë midis palëve, mund të jetë shprehja më e mirë e marrëveshjes italo-jugosllave që nuk u arrit akoma. Në qoftë se është kështu, ne nuk duhet të pengojmë përpjekjet e Italisë për të rivendosur pozicionin e saj në Shqipëri. Nga ana tjetër nuk bëhet fjalë që ne të ndërhyjmë pranë Mbretit Zog për ta detyruar atë për të pranuar kërkesat e Italisë.”⁵¹

Pas largimit të përkohshëm të Hodgson nga Shqipëria, FO i dërgon këtë mesazh të ngarkuarit me punë në Durrës Forester “ Në qoftë se Mbreti apo Ministri i Jashtëm do t’i kthehen kësaj çështjeje përsëri, ju duhet të mbani të njëjtin qëndrim me Hodgson dhe të bëni të qartë që qeveria britanike nuk është në gjendje të japë ndonjë këshillë se cila është politikë më e mirë për çështje individuale. Qeveria shqiptare nuk duhet të shpresojë që qeveria britanike do të jetë e gatshme për të ndërhyrë midis qeverisë shqiptare dhe asaj italiane për çdo çështje të mosmarrëveshjeve midis tyre.”⁵²

Orvatjet e Zogut për të shprehur ndjenjat e forta të nacionalizmit të tij brenda Shqipërisë me qëllim ngritjen e rezistencës ndaj presionit italian nuk jepnin me asnjë shkëndijë shpresë. Zogu u përpoq me kot për të siguruar aleatë të rinj politike në kufijtë e afërt dhe të largët të vendit të tij . Përfundimisht u provua se Shqipëria ishte përcaktuar të mbetej pjesë e padiskutueshme e interesit politik italian dhe të gjitha shtetet e tjera duhej ta kishin të qartë këtë rethanë.⁵³

⁵⁰ PRO, FO 371/18839, R4953/67/90, Durrës, 2 shtator 1934.

⁵¹ PRO, FO 371/18339, R4864/67/90, FO 30 gusht 1934.

⁵² PRO, FO371/18/839, R 4791/67/90, FO 27 shtator 1934.

⁵³ A.Cici, *vep. e përm.*, f.217.

